




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE BLLATË



Nr. 984/12 Prot.

Bllatë, më 14 / 08 / 2025

Lënda: Kërkesë për njoftim publik

DREJTORISË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

**DREJTORISË SË STATISTIKËS, PAGESAVE, ANALIZËS SË TË
ARDHUARVE DHE ADMINISTRIMIT TË BORXHIT**
Sektorit të Monitorimit të Borxhit dhe Bashkëpunimit me Tatimet

**DEPARTAMENTIT EKONOMIK DHE BURIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E ASETVE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

TIRANË

Në zbatim të marrjes së masave për rikuperimin e borxhit doganor, mbështetur në ligjin Nr.102/2014, datë 31.07.2014 « Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë », i ndryshuar , Udhëzimin nr.15, datë 03.12.2018 të DPD-së « Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës », kreu IV, pika 3/b, si dhe Ligjin nr.44/2015, datë 30.04.2015 « Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë » neni 162, pika 2 , kërkojmë kryerjen e njoftimit publik të vendimit nr.984 prot., datë 05.08.2025(Për rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor) të Degës Doganore Bllatë (Peshkopi); të marrë ndaj shtetasit Perikli Çaushaj me ID : H10512065E, duke e publikuar në rubrikën « Njoftime » të faqes “web” të Institucionit.


Bashkëlidhur keni kopje të vendimit nr.984 prot., datë 05.08.2025, të Degës Doganore Bllatë dhe shkresën “Njoftim Vendimi”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

KRYETARI

Bajram KALIA

Adresa: Bllatë, Njësia Administrative Maqellarë, Bashkia Dibër



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE BLLATË

PROTOKOLLI

VENDIM

Datë 05.04.2025

“Për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor”

Shtetasit: Perikli Çaushaj me ID: H10512065E

Dega Doganore Bllatë me vendimin nr. 39, datë 14.05.2025, ka vendosur kontabilizimin dhe arkëtimin e borxhit doganor në shumën gjithsej 171,940 lekë (42,985 lekë janë detyrim doganor dhe 128,955 lekë penalitet), që shtetasi Perikli Çaushaj ka ndaj Degës Doganore Bllatë. Njoftimi i vendimit të mësipërm është nisur me postë, por, posta e ka kthyer mbrapsht me shënimin “Adresë e pasaktë”, megjithëse e kemi nisur në adresën e deklaruar në gjendjen civile të subjektit. Ndodhur në këto kushte me shkresën nr.762/3 prot., datë 01.07.2025 i kemi kërkuar Bashkisë Tiranë, ku shtetasi ka vendbanimin, njoftimin publik të vendimit të mësipërm duke e afishuar në këndin e Njesisë/Bashkisë për njoftime publike. Me shkresën nr.23809/1 prot., datë 08.07.2025, bashkia Tiranë ka konfirmuar se ka kryer shpalljen publike të njoftimit të vendimit në datën e protokollimit, duke i kërkuar njëkohësisht Njesisë Administrative Nr.8, njësia ku debitori ka vendbanimin, që dhe ajo të kryejë afishimin e njoftimit në këndin e njesisë për njoftime publike. Njësia Administrative Nr.8 me shkresën nr.1782/1 prot., datë 22.07.2025 ka konfirmuar se ka kryer afishimin e njoftimit në datën e protokollimit. Në bazë nenit 162 pika 3 të ligjit nr.44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” me kalimin e 10 ditëve nga data e shpalljes/afishimit, njoftimi vlerësohet i kryer. Njëkohësisht ky vendim është shpallur/afishuar më datë 03.07.2025 dhe në faqen “web” të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave në rubrikën “njoftime”.

Meqë subjekti i mësipërm nuk ka kryer në mënyrë vullnetare, likuidimin e detyrimeve të përcaktur në vendimin nr. 39, datë 14.05.2025 të Degës Doganore Bllatë, brenda afatit 10 ditor nga marrja e njoftimit, me qëllim rikuperimin me forcë të borxhit doganor prej 171,940 *(njëqind e shtatëdhjetë e një mijë e nëntëqind e dyzet) lekë*, që shtetasi Perikli Çaushaj me adresë: *Bashkia Tiranë, Njësia Administrative nr.8, pallati nr.582, apartamenti nr.5*, ka ndaj Degës Doganore Bllatë, në zbatim të neneve 106,107 dhe 280 të Kodit Doganor, nenit 511 e vijues të K.Pr.Civile dhe Udhëzimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nr.15, datë 03.12.2018 “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”,

VENDOSA QË :

1. Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, valutë të huaj të depozituara në bankë që u përkasin debitorit, personave të tretë apo garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit të mësipërm.
2. Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme dhe të patundshme që i përkasin debitorit, personave të tretë apo garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
3. Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve të mësipërme, konkretisht shuma prej 171,940 *(njëqind e shtatëdhjetë e një mijë e nëntëqind e dyzet) lekë* dhe të kamatë vonesave deri në datën e likuidimit të plotë të borxhit doganor, në bazë të neneve 106,107 dhe 280 të Kodit Doganor.

KRYETAR

Bajram KALIA

Adresa: Bllatë, Njësia Administrative Maqellarë, Bashkia Dibër





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE BLLATË

Nr. 984/Prot.

Bllatë, më 05/08/2025

NJOFTIM VENDIMI

“PËR RIKUPERIMIN ME FORCË TË BORXHIT DOGANOR”

Drejtuar: **Shtetasit: Perikli Çaushaj me ID: H10512065E**

Adresa: *Bashkia Tiranë, Njësia Administrative nr.8, pallati nr.582, apartamenti nr.5*

Në zbatim të Ligjit nr.102, date 31.07.2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM Nr.651, datë 10.11.2017 “Per dispozitat zbatuese te Kodit Doganor”, i ndryshuar,

Ju njoftojmë se:

Dega Doganore Bllatë me **vendimin nr.39, datë 14.05.2025**, ka vendosur për shtetasin Perikli Çaushaj, të shpallet debitor për:

- Shumën **42,985 lekë** detyrime doganore
- Shumën **128,955 lekë** në formë sanksioni(penalitet)
- Kamatë vonesat deri në ekzekutimin e detyrimeve të papaguara.

Ky vendim ju është njoftuar përmes shpalljes publike në pamundësi për njoftimin me mjete të tjera kështu që vlerësohet marrja dijeni nga ana juaj. Në kushtet kur nga ana juaj nuk është kryer likuidimi në mënyrë vullnetare i detyrimeve të vendosura në vendimin e mësipërm, në zbatim të neneve 280, 283 të Kodit Doganor, Dega Doganore Bllatë, ka nxjerrë Vendimin nr. 984 prot., datë 05. 08 .2025 “Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor”, një kopje të të cilit e keni bashkëlidhur.

KRYETAR

Bajram KALIA

Adresa: *Bllatë, Njësia Administrative Maqellarë, Bashkia Dibër*